



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 1176 Prot.

Elbasan, më 28 . 02 . 2024

Vendim

Nr. 279 Datë 28 / 02 / 2024

Për përcaktimin e përgjegjësive dhe kompetencave

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrative të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8,9, 59 e 64 të tij, ligjin 44 datë 30.04.2015 "Kodi I Proçedurave Administrative", nenet 28 e 29 të tij,

Vendosa

- 1- Zv/Kryetari e Bashkisë z. Asim Sula, është përgjegjës për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin, e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikim-Zhvillimit Urban dhe Shërbimeve Infrastrukturore dhe strukturave vartëse të saj.
- 2- Në funksion të realizimit të përgjegjësive si më sipër, Zv/Kryetarit të Bashkisë z. Asim Sula i delegohen kompetencat si më poshtë:
  - *Të kontrollojë dhe nënshkruaj të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësive të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri, me përjashtim të instrumentave të planifikimit të territorit dhe lejeve të zhvillimit e ndërtimit, të cilat do të nënshkruhen nga Kryetari i Bashkisë*
  - *Kur për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë urdhër, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë, përveç kontratave të proçedurave të prokurimit publik, që nënshkruhen prej tij sipas paragrafit më poshtë.*
  - *Ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e Bashkise si "Autoritet Kontraktor" në fushën e prokurimeve publike, përfshirë nxjerrjen e urdhërave të prokurimit dhe nënshkrimin e kontratave, për të gjitha llojet e proçedurave të prokurimit, përfshirë dhe procedurat e "blerjeve të vogla"*
  - *Të nënshkruaj dokumentacionin e vërtetuar me origjinalin, të dalë nga arkiva e Bashkisë*
  - *Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si relacione, projekt-vendime etj, që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësive të*

*përcaktuara në këtë urdhër, si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të tij.*

- 3- Gjithashtu, zv/Kryetari z. Asim Sula, është përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e aktivitetit të Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale dhe asaj Urbane dhe Drejtorisë së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin
- 4- Aktet dhe shkresat zyrtare të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njëlloj, te detyrueshme, për administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
- 5- Ushtrimi i këtyre detyrave dhe kompetencave do të bëhet nga data 28/02//2024 deri në një urdhër të dytë.
- 6- Zv Kryetari z. Asim Sula nuk mund të delegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera
- 7- Zv/kryetari z. Asim Sula, do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim
- 8- Vendimet nr 2474 datë 31.10.2023, nr 2477 datë 31.10.2023, të Kryetarit të Bashkisë dhe të gjitha aktet e tjera të delegimit të kompetencave për ish zv/kryetaren znj. Vesa Liço, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi
- 9- Ngarkohen zv/kryetari z. Asim Sula dhe administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, me publikimin e tij
- 10- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë

Kryetari  
Gledian Llatja

